



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN



Drejtoria i Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Datë/Datum/ Date:	13.02.2025
Për/Za/For:	z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës z. Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës z. Avni Jashari - Shef i Kabinetit të Kryetarit
Nga/Od/From	z. Rexhep Rexhepi - Drejtori i Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari
Lënda/Subjecat/Subject:	Raporti për muajin Janar

I nderuar Kryetar Z. Imri Ahmeti,

Të bashkangjitur gjeni Raportin mujor të aktiviteteve të Drejtoratit të Bujqësisë për periudhën nga 03.01.2025 deri me 31.01.2025

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

SEKTORI I BUJQËSIË

Muaji janar ka shënuar fillimin e aktiviteteve për këtë vit, duke u fokusuar në planifikimin strategjik dhe organizimin e punëve të Drejtoratit të Bujqësisë. Gjatë kësaj periudhe, kemi zhvilluar takime me stafin për të përcaktuar prioritetet dhe për të siguruar një qasje të mirëkoordinuar për realizimin e projekteve në mbështetje të fermerëve dhe zhvillimit të sektorit bujqësor. Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të realizuara gjatë muajit janar dhe hapat e ardhshëm në vazhden e implementimit të projekteve bujqësore.

Në fillim të muajit, është mbajtur një takim me të gjithë stafin e Drejtoratit të Bujqësisë, ku është diskutuar plani vjetor i punës. Diskutimi është fokusuar në prioritetet e vitit, përgatitjen për procesin e subvencioneve, si dhe në rritjen e efikasitetit të shërbimeve që ofrohen për fermerët.

Një nga temat kryesore të takimit ishte përgatitja e stafit për subvencionet dhe pagesat direkte, të cilat pritet të hapen në fund të muajit shkurt. U theksua rëndësia e një koordinimi të mirë mes stafit për pritjen e fermerëve për të siguruar një proces të rregullt dhe të lehtësuar të aplikimit.

Gjatë muajit janar, një ndër aktivitetet më të rëndësishme ka qenë fillimi i montimit të serrave për përfituesit në terren. Ky projekt synon të mbështesë fermerët në zhvillimin e prodhimit të perimeve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre për të siguruar prodhim të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit.

Procesi i montimit ka filluar në fillim të muajit dhe është duke vazhduar, gjithashtu kemi bërë vizita në teren për të parë nëse gjithçka është në rregull dhe pritet që deri në javën e parë të muajit mars të përfundojë plotësisht ky projekt, duke mundësuar fermerëve të fillojnë prodhimin në hapësirat e reja të kultivimit.

Gjatë muajit janar është hapur aplikimi për cilësisë dhe sasisë së qumështit, një program i ofruar nga Ministria e Bujqësisë. Ky program synon të mbështesë fermerët e blegtorisë duke siguruar një vlerësim të standardeve të qumështit dhe ofrimin e subvencioneve për prodhimin e qëndrueshëm dhe cilësor. Fermerët kanë dorëzuar aplikimet e tyre në Drejtoratin e Bujqësisë në Komunë, dhe të njëjtat lënd e aplikuar do të përcillen në Ministri të Bujqësisë për shqyrtim.

Një tjetër aktivitet i rëndësishëm gjatë këtij muaji ka qenë diskutimi me organizatën IADK për mundësinë e bashkëpunimit në projektet bujqësore gjatë muajve në vijim. Synimi i këtij bashkëpunimi është të ofrohet mbështetje për fermerët përmes pajisjeve dhe makinerive bujqësore, duke përmirësuar kështu produktivitetin dhe efikasitetin në punën e tyre. Nga ky projekt, një numër i konsiderueshëm i fermerëve do të përfitojnë pajisje.

Ky bashkëpunim është në fazën fillestare të negocimit dhe pritet që në muajt në vijim të konkretizohen në mes së Komunës së Lipjanit dhe IADK-së.

Në kuadër të përgatitjeve për sfidat që mund të shfaqen gjatë vitit, gjatë janarit është formuar Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve në Bujqësi për vitin 2025. Ky komision do të ketë për detyrë të:

- Vlerësojë kërkesat e fermerëve për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore si breshëri, thatësira, përmbytjet etj.
- Hartojë raporte për situatat e shkaktuara nga faktorë të ndryshëm dhe të rekomandojë masa mbështetëse për fermerët e prekur.

Ky hap është shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e interesave të fermerëve dhe për sigurimin e një reagimi të shpejtë në rast të fatkeqësive natyrore apo të tjera që mund të ndikojnë në prodhimin bujqësor.

Muaji janar ka qenë një periudhë e ngjeshur me aktivitete të rëndësishme për planifikimin dhe implementimin e projekteve bujqësore. Kemi arritur të vendosim bazat për një vit të suksesshëm, duke fokusuar përpjekjet në mbështetjen e fermerëve, zhvillimin e infrastrukturës bujqësore dhe përmirësimin e proceseve administrative.

Në muajt në vijim, do të vazhdojmë të zbatojmë planet dhe projektet e planifikuara, duke synuar një rritje të qëndrueshme të sektorit bujqësor dhe një përmirësim të kushteve për të gjithë fermerët.